



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2020:921370

Datë: 08.04.2024

Numri i dokumentit: 05569489

KF.nr.27/23

GJYKATA KOMERCIALE, Dhomat e shkallës së parë, Departamenti Fiskal, me gjyqtarën Vera Gashi Bala dhe me zyrtarën ligjore Arta Hyseni, në konfliktin administrativ të paditësit “Ex-Project” Sh.P.K. me seli në Ferizaj, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson Shoqëria e Avokatëve “SCLR Partners” – Prishtinë kundër të paditurit Dogana e Kosovës me seli në Prishtinë, në rigjykim-rivendosje sipas Aktvendimit AA.nr.628/2019 të datës 13.01.2022 i Gjykatës së Apelit të Kosovës – Departamenti për Çështje Administrative, duke vendosur lidhur me padinë e paditësit për anulimin e Aktvendimit, me bazë juridike: rivlerësim doganor në seancën e shqyrtimit gjyqësor-kryesor publik, të mbajtur me datë 27.03.2024, në prani të autorizuarit të palës paditëse G.B., të autorizuarit të palës së paditur M.K., mori këtë:

A K T G J Y K I M

- I. REFUZOHET kërkesëpadia e paditësit “Ex-Project” Sh.P.K. me seli në Ferizaj, në tersi si e pa bazuar.
- II. MBETËT NË FUQI Aktvendimi nr. 07.3/153 i datës 04.03.2016, i Doganës së Kosovës në Prishtinë.
- III. Secila palë i bartë shpenzimet e veta të procedurës.

A r s y e t i m

Paditësi përmes të autorizuarit të tij, me padinë e parashtruar në gjykatë, me datë 12.04.2016, ka iniciuar konfliktin administrativ kundër të paditurës Dogana e Kosovës, duke kërkuar anulimin e Aktvendimit nr. 07.3/153 të datës 04.03.2016, të paditurës Dogana e Kosovës, për shkak të

konstatimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, aplikimit të gabuar të dispozitave materiale dhe për shkak të shkeljeve të dispozitave materiale. Përfaqësuesi i palës paditëse si në padi, në seancën kryesore dhe në fjalën përfundimtare ka deklaruar se mbesin në tërësi pranë padisë dhe deklarimeve nga seancat e kaluara. Më tej thekson se konsiderojnë se e paditura ka lëshuar vendim në kundërshtim me gjendjen reale dhe faktike dhe në kundërshtim me dispozitat ligjore e paditura e ka obliguar paditësen që në emër të taksës së akcizës të paguajë për të gjithë peshën e mallit kontestues përkatësisht fishekzjarrëve e cila ka në përmbajtje një sasi të barutit mall i cili është akcizor. Në këtë konflikt administrativ është propozuar nxjerrja e provës të bëhet me ekspertizë financiare dhe eksperti me vendim të gjykatës ka pasë për detyrë që të llogaritë vlerën e akcizës për sasinë e barutit e cila ka qenë e cekur në të gjithë DUD-at kontestues dhe në këtë mënyrë të nxjerrët diferenca midis vlerësimit të mallit nga e paditura dhe të vlerës së llogaritur për sasinë e barutit i cili ka qenë në përmbajtje të fishekzjarrëve. Ka përfunduar se konsiderojnë se ekspertiza i është përmbajtur detyrave të caktuara nga gjykata me kërkesë që gjykata ta aprovojë si të bazuar kërkesëpadinë e paditësit, të anulojë vendimin e kontestuar dhe të obligojë të paditurën që t'ia kthej paditësit mjetet monetare të paguara më tepër në emër të akcizës në shumën prej 28,647.80 euro dhe të taksës së TVSH –së në shumën prej 5,156.60 euro në total prej 33,804.40 euro sipas ekspertizës financiare të gjitha këto me kamatë ligjore prej 8% si të cekur më lartë.

E paditura, në përgjigje në padinë të datës 21.06.2018, e konteston në tërësi si të pa bazuar kërkesëpadinë e paditësit. Shton se aktvendimi është marrë konform të gjitha dispozitave në fuqi dhe ajo në të cilën pretendon pala se ky vendim është marrë me shkelje ligjore nuk qëndron fare me arsyetimin se vendimi i atakuar është marrë konform legjislacionit në fuqi dhe në mënyrë të drejtë, ndërsa pala paditëse pretendimet e veta nuk i ka vërtetuar as edhe me një provë të vetme. Në seancën e shqyrtimit gjyqësor dhe në fjalën përfundimtare e paditura e ka kontestuar në tërësi padinë dhe kërkesëpadinë e paditësit. Tutje ka theksuar se mbesin në tërësi pranë aktvendimit kontestues duke konsideruar se i njëjti është i drejtë dhe i ligjshëm dhe bazohet në Kodin Doganor dhe në vendimin e Qeverisë i cili e rregullon këtë çështje. Paditësi ka deklaruar mallin me deklaratën doganore 1264/2016 duke deklaruar peshën bruto dhe neto të mallit në bazë të të cilës dogana i ka kalkuluar taksën e akcizës, andaj edhe pretendimet e tij janë të pabazuara dhe të pambështetura në asnjë provë të vetme. Ekspertizën financiare e kemi pranuar dhe analizuar në tërësi dhe duke u bazuar në aktvendimin me të cilin është caktuar eksperti dhe gjithashtu me të cilin detyrat janë dhënë

konsiderojmë se eksperti ka dalë tërësisht nga detyra e vet financiare doganore duke komentuar normat ligjore të vendimit të Qeverisë dhe duke bërë krahasime me llogaritje të normës së alkoolit dhe e cila është tërësisht e ndryshme nga kjo lëndë andaj edhe nuk mund të bëhen krahasime të tilla. Ekspertiza e administruar si provë në mënyrë të padrejtë dhe tërësisht jo profesionale e kontestohen nenin 1 të vendimit 04/39 të vitit 2015 ku në mënyrë të qartë sqarohet se pagesa prej 2 euro në kg është për fishekzjarrë dhe jo për barut siç e ka deklaruar edhe vet pala në deklaratën doganore. Andaj bazuar në këto i kërkojmë kësaj gjykate që të merre aktgjykim me të cilin e hedh në tërësi padinë dhe kërkesë padinë e paditësit dhe e lë në fuqi vendimin kontestues të të paditurës.

Me qëllim të vërtetimit të drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike, Gjykata në procedurën e provave të shqyrtimit kryesor-publik të datës 27.03.2024, ka administruar provat dhe atë: Aktvendimi 07.3/153 i datës 04.03.2016, Deklaratë doganore, Fatura e mallit, Packing list 1, Kontrata e shitjes, Pagesat bankare, Vendimi nr. 04/39 e datës 22.07.2015 i Qeverisë së Republikës së Kosovës, Ekspertiza financiare dhe dokumentacioni shtesë i ekspertizës i datës 25.01.2019, Aktvendimi AA.nr. 628/2019, Ekspertizë e datës 04.01.2023 pranuar në gjykatë me datë 12.01.2023, Aktvendimi A.nr 545/16.

Gjykata vlerësoi ligjshmërinë e vendimit kontestues, thëniet në padi, përgjigjes në padi, shkresave të lëndës në këtë konflikt administrativ, bëri vlerësimin e secilës provë veç e veç dhe të gjithave se bashku, mbështetur edhe në dispozitat nga neni 8, i Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK-së), dhe arriti në përfundimin se në këtë konflikt administrativ, duhet vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, për këto arsye:

Gjykata e Apelit e Kosovës – Departamenti për Çështje Administrative, me aktvendimin AA.nr.628/2019 të datës 13.01.2022, ka prish aktvendimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë, Departamenti për Çështje Administrative-Divizioni Fiskal, me nr. A.nr.545/16, të datës 30.04.2019, me të cilin ishte refuzuar kërkesëpadija e paditësit, dhe i ka kthyer lëndën në rigjykim dhe rivendosje kësaj Gjykate, duke vlerësuar se aktvendimi i lartcekur është i përfshirë në shkelje të dispozitave thelbësore të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2 pika k) e LPK-së, që janë të atilla që e pengojnë vlerësimin e ligjshmërisë së aktgjykimit të goditur. Gjykata e apelit ka gjetur se gjykata e shkallës së parë nuk i është përgjigjur pretendimeve të paditësit se e paditura në kundërshti me

njësinë konvencionalle të blerjes apo shitjes së fishekzjarrëve ka vlerësuar këtë mall doganor duke caktuar taksën e akcizës për tërë peshën e mallit edhe pse në këtë peshë bëjnë pjese edhe materiale tjera, ndërsa për alkoolin dhe cigaret akciza aplikohet ndryshe. Në ri procedurë gjykata e shkallës së parë duhet të shqyrtojë të gjitha vërejtjet e dhëna, dhe duhet të bëjë vlerësimin e ligjshmërisë së aktvendimit kontestues të Doganës së Kosovës, t'i eliminoj të gjitha shkeljet e theksuara, të vendos në kuptim të nenit 160 të LPK-së ashtu që dispozitivi dhe arsyetimi i vendimit të jetë i qartë dhe i kuptueshëm duke vlerësuar të gjitha provat veç e veç dhe të gjitha së bashku.

Gjykata vlerësoi ligjshmërinë e vendimit kontestues, thënieve në ankesë, përgjigjen në padi, shkresat e lëndës në këtë konflikt administrativ, dhe konstatoi se kërkesëpadija e paditësit është e pabazuar, për arsyet si në vijim:

Nga provat e administruara në këtë konflikt administrativ, nga deklaratimet në ankesë/padi, shkresat e lëndës, aktvendimi kontestues, dhe deklarimeve në seancën e shqyrtimit gjyqësor, Gjykata ka nxjerr konstatimin se Zyra e Pranimit gjatë vlerësimit të mallit lëndor për DUD kontestues ka vlerësuar si provë të mjaftueshme dokumentacionin përcjellës të mallit ashtu siç është deklaruar dhe ka respektuar vendimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës të datës 22.07.2015, me të cilin është ndryshuar norma e akcizës për produktet e importuara përmes DUD kontestues.

Nga ekzaminimi i vendimit kontestues, Gjykata konstaton se e paditura me aktvendimin kontestues e ka refuzuar kërkesën e subjektit në procedurë këtu paditësit, e cila me rastin e shqyrtimit të kërkesës së paditësit për rishqyrtimin e DUD-it R-1264/01.02.2016 të lëshuar nga ZBD Ferizaj, konfirmon rivlerësimin e importit të mallit lëndor fishekzjarr, sipas normës së re të akcizës sipas vendimit nr.04/39 datë 22.07.2015 të nxjerr nga Qeveria e Republikës së Kosovës. E paditura Dogana e Kosovës në vendimin e vet kontestues ka refuzuar kërkesën e paditësit me arsyetimin se vendimi 04/39 datë 22.07.2015 nuk mund të ketë efekt retroaktiv ndaj paditësit, andaj vendimi është i obligueshëm për ekzekutimin e tij ditën e hyrjes në fuqi me datë 22.07.2015 ndërsa momenti i kontraktimit nuk mund të merret për bazë për tu aplikuar dispozitat ligjore të cilat janë nxjerr më vonë dhe janë të obligueshme për zbatim nga dita e nxjerrjes së tyre. Nga kjo gjendje faktike, Gjykata ka pranuar si të bazuar arsyetimin e vendimit të të paditurës, për arsye se paditësi nuk ka arritur të argumentojë me prova konkrete një gjendje tjetër faktike nga ajo që është vërtetuar nga e paditura

me vendimin kontestues dhe se dëshmitë e parashtruara nga paditësi nuk kanë ndikim në vendosje ndryshe në këtë çështje administrative.

Gjykata ka shqyrtuar ligjshmërinë e aktit administrativ brenda kufijve të kërkesëpadisë, ne vështrim të nenit 44 të LKA-së. Gjykata nuk ka mundur t'i merr për bazë pretendimet tjera të paditësit të shprehura në padi dhe gjatë shqyrtimit kryesor sepse të njëjtat janë në kundërshtim me gjendjen faktike të vërtetuara nga ana e organit të paditur, në kundërshtim me provat në shkresat e lëndës dhe me dispozitat ligjore në fuqi.

Pretendimin e paditësit se për mallin lëndor ka paraqit urdhërpagesat bankare, kontratën e shitjes, të cilat prova dëshmojnë se paditësi ka bërë kontraktimin e mallit nga eksportuesi para se të hyj në fuqi vendimi 04/39 i Qeverisë së Kosovës. Gjykata i pranon konstatimet e të paditurës se vendimi nr.04/39 i datës 22.07.2015 i Qeverisë së Republikës së Kosovës është i obligueshëm për ekzekutim në ditën e hyrjes së tij në fuqi, pra prej datës 22.07.2015, prandaj edhe rivlerësimi i mallit lëndor me normën e re të akcizës sipas vendimit nr.04/39 datës 22.07.2015, gjykata e konsideron si vendim të drejtë, për arsye se nga shkresat e lëndës shihet se DUD kontestues ka datë 01.02.2016, Packing list datë 11.11.2015 dhe Fatura datë 03.08.2015, që do të thotë se paditësi ka paraqitur për zhdoganim mallin lëndor fishekzjarr me anë të DUD-it R-1264/01.02.2016 pas marrjes së vendimit të Qeverisë së Kosovës 04/39 i cili ka hy në fuqi nga data 22.07.2015. Andaj Gjykata me të drejtë ka pranuar konstatimet e cekura në arsyetimin e vendimit kontestues se importet e mallit kanë ndodhur pas hyrjes në fuqi të vendimit të Qeverisë dhe se mallrat zhdoganohen sipas normës së re të akcizës që ka hyrë në fuqi me datën 22.07.2015. Nga kjo gjendje faktike, Gjykata ka pranuar si të bazuar arsyetimin e vendimit të të paditurës, për arsye se paditësi nuk ka arritur të argumentojë me prova konkrete një gjendje tjetër faktike nga ajo që është vërtetuar nga e paditura me vendimin kontestues dhe se dëshmitë e parashtruara nga paditësi nuk kanë ndikim në vendosje ndryshe në këtë çështje administrative.

Në Ekspertizën Financiare të datës 12.01.2023, eksperti financiar ka dhënë mendimin dhe konstatimin se aplikimi i tatimit-taksës së akcizës bazuar në Vendimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës 04/39 të datës 22.07.2015 është i paqartë dhe ka munguar udhëzimi për interpretimin e këtij vendimi (sikurse tek aplikimi i të njëjtës masë tek alkooli i pastër-përçindja e alkoolit në

produktet të cilat përmbajnë alkool), nëse Gjykata e jep opinionin e saj të interpretimit juridik dhe konstaton se edhe për fishekzjarrë duhet të aplikohet ky tatim-takës e akcizës mbi bazën e përqindjes apo sasisë së eksplozivit -barutit që përmbanë, atëherë Dogana e Kosovës ka aplikuar me tepër tatimin taksën e akcizës si dhe TVSH më tepër për DUD-in kontestues në vlerë prej 33,804.40 Euro. Ekspertiza ka nxjerr përlllogaritjen në sasinë e barutit në mallin kontestues, dhe ka lënë që Gjykata të bëjë interpretimin e Vendimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës.

Gjykata konstaton se, nga provat në shkresat e lëndës rezulton se e paditura për rishqyrtimin e DUD R-1264/01.02.2016, lëshuar nga ZBD Ferizaj, vendosi një rivlerësim të importeve mallra fishekzjarrë sipas normës së re për akciza sipas vendimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 04/39 të datës 22 korrik 2015. Dogana e Kosovës në vendimin e kontestuar ka refuzuar kërkesën e paditësit me arsyetimin se vendimi 04/39 i datës 22.07.2015 nuk mund të ketë fuqi prapavepruese në lidhje me paditësin, por vendimi është i detyrueshëm për ekzekutim atë ditë kur hyn në fuqi, pra më 22 korrik 2015 dhe se importi është bërë pas kësaj date, që nënkupton pas hyrjes në fuqi të vendimit të lartpërmendur të Qeverisë së Republikës së Kosovës.

Rrjedhimisht, gjykata konstaton se nuk mund të përdoren si bazë për vendimmarrje në këtë çështje juridike dëshmitë e paditësit se ka dorëzuar urdhërpagesë bankare, vërtetim për mallin në fjalë shitjet, pra provat që tregojnë se paditësi i ka kontraktuar mallrat nga eksportuesi para hyrjes në fuqi të vendimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 04/39 nga 22 korrik 2015. Prandaj Dogana e Kosovës ka vepruar në mënyrë të bazuar në ligj kur ka rivlerësuar mallrat në fjalë në bazë të normave të reja për akcizat sipas vendimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 04/39 nga 22 korrik 2015 i cili në nenin 1 paragrafi 1, përcakton se vendoset norma e akcizës në shumë prej 2 euro për kilogram për fishekzjarrë, raketat ndriçuese për sinjale, raketa për kohë shiu, sinjalet për mjegull dhe artikuj të tjerë piroteknike me kodin tarifor 3604, dhe se i njëjti nen nuk diferencon elemente tjera të cilat do të rezultonin në llogaritjen neto të eksplozivit/barutit në fishekzjarrë dhe artikujt e tjerë të cekur në nenin 1, por qartazi thekson se norma e akcizës është 2 euro për kilogram të këtyre artikujve të ashtuquajtur piroteknike, e që kjo gjykatë si të tillë e interpreton në sasi bruto të fishekzjarrëve. Ekspertizën e punuar gjykata nuk e mori për bazë pasi që e njëjta nuk i është përmbajt detyrave të caktuar për llogaritjen e normës së akcizës për kg në sasi bruto të mallit të importuar, por e njëjta duke bërë krahasimin me alkoolin ka nxjerr kalkulime duke llogaritur vetëm

sasinë neto të eksplozivit/barutit, e cila për gjykatën konfom vendimit të lartcekur të Qeverisë së Kosovës, nuk gjen zbatim në rastin konkret. Ndërsa, përlllogaritja bruto rezulton të mos jetë kontestuese në mes të palëve ndërgjyqëse, por kontestuese mbetet nëse llogaritja e akcizës duhet bërë në sasi të barutit të mallit lëndor.

Në këtë drejtim, gjykata shqyrtoi bazën ligjore, përkatësisht kreun II të nenit 24 të Kodit Doganor dhe i Akcizave të Kosovës nr. 03/L-109 i cili përcakton se: *“Detyrimet e importit për t’u paguar ligjshmërisht kur lind një borxh doganor, bazohen në nomenklaturën e mallrave të TARIK-ut, Tarifës Doganore të Kosovës, ligjeve të zbatueshme në Kosovë dhe çdo marrëveshje me një vend tjetër apo grup vendesh, ku hyn edhe Kosova kur merren masa për lejimin e trajtimit preferencial tarifo”*, ndërsa paragrafi 3 i nenit 24 ka përcaktuar se çka përfshin TARIK-u dhe në pikën 2 (a) parashihet se *“Cilido ligj i Kosovës i cili parasheh shkallët e detyrimeve doganore, taksave dhe formave tjera të detyrimeve që zbatohen normalisht mbi mallrat e përfshira në TARIK;”*. Rrjedhimisht, Gjykata konstaton se e paditura edhe ne bazë të deklaramit të mallit nga importuesi të klasifikuar në numrin tarifor 3604 duke zbatuar vendimin e qeverise, ka aplikuar drejte dispozitat ligjore ne vendimin kontestues.

Nga vendimi i Qeverisë kuptohet se bëhet fjalë për vendosjen e normës se akcizës për kilogram ne fishekzjarrë dhe jo norme te akcizës për barut ose ndonjë element tjetër. Gjithashtu pretendimet e paditësit se ngarkimi i akcizës ne këtë rast ne peshën neto mund te aplikohen ne mënyrë analoge si ne alkoolin te pijet alkoolike për alkoolin e pastër duhet paguhet akcize, kjo për faktin se analogjia e tillë nuk është e paraparë, meqenëse vendosja e akcizës për alkoolin tashmë është e rregulluar me kapitullin 22 të TARIKUT dhe atë me nën krerët 2201 e tutje, ku edhe parashihet akciza në përqindje të alkoolit. Gjykata vlerëson se në rastin konkret analogjia nuk gjen zbatim, kjo për faktin se tashmë ekziston vendimi i Qeverisë, i cili e rregullon akcizën për mallin lëndor dhe se i njëjti vendim nuk parasheh ndarje të barutit/eksplozivit, por e përshkruan si mall i plotë “fishekzjarrë” dhe qartë përcakton se akciza është 2 Euro në Kg.

Mbi këtë gjendje të fakteve, Gjykata erdhi në përfundim se në këtë çështje administrative drejt është vërtetuar gjendja faktike, nga e cila del se nuk është cenuar ligji në dëm të paditësit, andaj

thëniet e padisë nuk i aprovoj sepse i vlerësoj të pa ndikim në vërtetimin e një gjendje tjetër faktike nga ajo e vërtetuar nga e paditura.

Nga të cekurat me lart, Gjykata konform dispozitave ligjore të nenit 43, par 1, dhe 46, par 1 dhe 2, të LKA-së, vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA KOMERCIALE

Dhomat e shkallës së parë, Departamenti Fiskal

KF.nr.27/23 datë 27.03.2024

Gjyqtarja
Vera Gashi Bala

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi, është e lejuar ankesa në afat prej 15 ditësh nga dita e marrjes së këtij aktgjykimi, dhomave të shkallës së dytë, përmes dhomave të shkallës së parë të kësaj Gjykate.